



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.73/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Laziç dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterit në hapsira publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë dhe subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Prishtinë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 650 (*gjashtëqind e pesëdhjet*) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (*pesëmbëdhjetë*) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 25.09.2017 në rrugën “Tirana” që lidhet me rreth rrotullimin për rrugën e Hekurudhave në Prishtinë, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatëve për anëtar të Kuvendit Komunal, Prishtinë nga radhët e subjektit politik PDK, të vendosura në hapsira publike.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) e LZP-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur dy fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2017, subjekti politik PDK, thekson se shkelja e bërë nuk është e qëllimshme dhe se ky veprim është bërë nga aktivistë të pa informuar mirë lidhur me nenin 4.1 pika b) i Rregullës Zgjedhore nr. 11/2013. Për më tepër ka theksuar se i kanë ndërrmar masat e duhura për të përmirësuar shkeljet e pretenduara ankimore. Si dëshmi ka bashkangjitur dyfotografit me të cilat shihet se janë larguar panot reklamuese nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik PDK janë vendosur në rreth rrotullimin e hekurudhës gjegjësisht në hapsira dhe në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, janë vendosur në hapsira dhe në rrugë publike, të cilën shkelje e ka pranuar edhe vet subjekti politik PDK në përgjigjen në ankes të datës 27.09.2017

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik PDK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterat reklamuese të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik PDK, janë vendosur në hapsira publike. Po ashtu si rrethanë, Paneli mori edhe faktin se subjektin politik në fjalë ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr panon nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

ZL. Anr.73/2017 më datën 28.09.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.